

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, shpallë:

KONKURS PËR STUDIME BAÇELOR

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor në vitin akademik 2026/2027

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 92 të Statutit ka miratuar propozimet e njësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2025/26 dhe në mbledhjen e mbajtur me 05.06.2026 miratoi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – baçelor. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejme MASHTI) me shkresën nr. 01/2411 datë 16.06.2026.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. UShAF në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik **2026/27**, do të regjistrojë **390** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, UShAF do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri në 46 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë, do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në UShAF, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci, Medvegja deri **2%** përkatësisht **7** studentë, si dhe **2%** përkatësisht **7** studentë nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, dhe **1%** përkatësisht deri **6** studentë nga Mali i Zi. Kandidatët, të cilët kanë lindur në vendet e sipërshtuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'i nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim sikurse kandidatët nga Kosova.
4. Përfshihet kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. UShAF nuk do të mundësojë lehtësime për pranim, nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
6. Të drejtë pranimi në UShAF kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë, në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
7. Në UShAF mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët

nga Kosova.

8. Kandidatë jo-kosovarë, konsiderohen kandidatët, të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'u verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHTI, e cila u dorëzohet të gjitha njësive akademike.
9. Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të dokumentohet në bazë të nostrifikimit nga organet kompetente. Vendimi për njohjen dhe barasvlerën e diplomës merret në MASHTI.
10. UShAF do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim.
11. Njësitë akademike përkatëse, me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti joshumicë, bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
12. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 383 të Kodit Penal (KODI NR. 06/L-074) të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale.
13. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UShAF, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UShAF pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
14. **Kandidatët për pranim si studentë në UShAF në vitin akademik 2026/2027 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se në një program të studimit.**

14.1. Kandidatët kanë të drejtë që me rastin e aplikimit përveç zgjedhjes së parë të programit të studimit, të deklarohen për opcionin (zgjedhjen) edhe të programeve tjera të studimit nëse nuk pranohen në zgjedhjen e parë brenda njësisë së njëjtë akademike apo edhe në njësitë tjera akademike të UShAF.

14.2 Në rast se kandidati nuk arrin të pranohet në opcionin e parë për shkak të konkurrencës, ai do të konsiderohet për pranim në opcionin e dytë apo të tretë e me radhë, vetëm nëse në ato programe ka vende të lira.

14.3 Rënditja në listën përfundimtare të atyre që kanë zgjedhur opcionin e dytë apo të tretë e me radhë do të bëhet në bazë të pikëve, pa cenuar të drejtën e kandidatëve që e kanë zgjedhur atë program si opcion të parë dhe kanë më pak pikë. E njëjta rregull aplikohet edhe për opsionin e dytë apo të tretë e me radhë.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. **Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:**
 - a) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë: -

 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:

 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
 - Pikët nga lëndët prioritare (3 lëndë) deri në 40 pikë.
- Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit më së shumti me 5 pikë.
2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**

3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen, edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
4. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
6. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e UShAF.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë së njëjtë, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.
8. Kandidatët të cilët kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë konkurs do të regjistrohen automatikisht si studentë të universitetit në vitin e parë të studimeve përmes sistemit online, menjëherë pas përfundimit të procesit të pranimi.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi online fillon nga data **29.06.2026** dhe zgjatë deri më **09.07.2026** në ora 16.00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **29.06.2026**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **10:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **29.06.2026** deri më datën **09.07.2026** (dokumentet do të pranohen çdo ditë, me përjashtim të të dielave). Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës.
4. **Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
 - a) *Fletëparaqitjen e plotësuar, e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: www.ushaf.net/apliko***
 - b) *Ekstraktin e lindjes ose certifikatën e lindjes(origjinal), jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;*
 - c) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal apo të noterizuara ose dublikat);*
 - d) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme (origjinal apo të noterizuar ose dublikat);*
 - e) *Certifikatën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal apo të noterizuar ose dublikat);*
 - f) *Kopjen e letërnjoftimit;*
 - f) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*
 - g) *Një fotografi (madhësia: 4.5 x 6.0 cm), e cila duhet të jetë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.*

Vini re: gjatë aplikimit online, duhet të ngarkohet një fotografi digjitale në sistemi për aplikim online, e cila duhet të jetë e njëjtë me atë që dorëzohet në formë fizike bashkë me dokumentet.

Formati i fotos digjitale:

Madhësia: 4.5 cm x 6.0 cm,

Formati digjital: JPEG (.jpg) ose PNG,

Përmasat digjitale të rekomanduara: minimumi 600 x 800 pikselë,

Pesha e fajlit: maksimum deri në 1 MB,

Konform Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 09/2021 të MASHTI, kandidatët që aplikojnë për studimet baçelor, lirohen nga pagesa për aplikim apo për provim pranues.

5. Me rastin e aplikimit të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 4 t'i dorëzojnë në Administratën e Universitetit në dosje (fasikël) të bardhë (e pashënuar me emër dhe mbiemër).
6. Dokumentet në pikën b), c) dhe d) mund të pranohen duplikat vetëm nëse dëshmohen me vërtetim nga organet kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje, etj. **P.s. PAS NXJERRJES SË DOKUMENTEVE DUBLIKAT, DOKUMENTET ORGJINALE NUK MUND TË SHFRYTËZOHEN NGA KANDIDATI, PASI QË KY VEPRIM KONSIDEROHET VEPËR PENALE.**
7. Njoftimet dhe oraret, ku do të mbahen provimet pranuese, mund të merren në ueb faqen e Universitetit. Data e mbajtjes së provimeve pranuese në Universitet do të jetë me 10.07.2026 ora 9:00.
8. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!
9. Shpallja e rezultateve të provimit pranues dhe rezultateve preliminare bëhet më datë 10.07.2026, ndërsa rezultatet përfundimtare shpallen më 14.07.2026 në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqen e Universitetit.
10. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç 'regjistrim nga fakulteti.
11. **Në programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**
12. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'i drejtohen Administratës Qendrore ose ta vizitojnë faqen e Universitetit **www.ushaf.net**

Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, respektivisht pas datës 14.07.2025 ku sistemi do të bënë regjistrimin si student i universitetit në mënyrë automatike.

Nëse vendet e rezervuara për komunitetet jo shumicë dhe për shqiptarët jashtë Kosovës nuk do të plotësohen, atëherë vendet e tyre do të zëvendësohen me kandidatët e ranguar në listë si të pa pranuar, duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimit.

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund të paraqesin ankesë pas publikimit të rezultateve preliminare, përkatësisht me datën **13.07.2026 nga** ora 13:00 deri 16:00. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave.
2. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në Administratën Qendrore të UShAF me datë **15.07.2026.**

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve баçелор në këtë afat të konkursit do të regjistrojë **390** studentë në fakultetet si në vijim:

PLANIFIKIMI I NUMRIT TË STUDENTËVE PER VITIN AKADEMIK 2026/2027						
Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvexha	Kandidatët nga Shqipëria & Maqedonia	Kandidatë nga Mali i zi	Numri i studenteve qe do te pranohen ne afatin e pare sipas vendimit te Senatit
		12%	2%	2%	1%	
Gjithsej	324	46	7	7	6	390
Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	59	8	2	2	1	70
Programi: Arkitekturë i Interierit dhe Dizajni i Mobileve, BSc	59	8	1	1	1	70
Fakulteti i Arteve të Aplikuara	32	5	1	1	1	40
Programi: Dizajn Grafik dhe Multimedia, Bachelor Profesional	32	5	1	1	1	40
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	50	7	1	1	1	60
Programi: Menaxhment i Hotelerisë dhe Turizmit, BSc	50	7	1	1	1	60
Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	100	14	2	2	2	120
Programi: Inxhinieri Industriale me Informatikë, BSc	50	7	1	1	1	60
Programi Informatik e Aplikuara, BSc	50	7	1	1	1	60
Fakulteti i Menaxhmentit	83	12	2	2	1	100
Programi: Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia. BSc	83	12	2	2	1	100
TOTALI	324	46	7	7	6	390

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për kandidatët, të cilët nuk kanë të kryer maturën mbahet nga lëndët e lëmive të ngushta profesionale, të programeve të fakultetit dhe atë:

- Në Programin: Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve, BSc, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit, BSc, nga lëndët: Ekonomi/ Ndërmarrësi, Gjeografi/ Histori, Informatikë/TIK;
- Në Programin: Inxhinieri Industriale me Informatikë, BSc, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Informatika e Aplikuar, BSc, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, BSc, nga lëndët: Informatikë/TIK, Matematikë, Ekonomi/ Ndërmarrësi.
- Në Programin: Dizajn Grafik dhe Multimedia, Bachelor Profesional, nga lëndët: Informatikë, Lëndët nga fusha e Arteve, Gjuhë Angleze.

Për kandidatët me maturë, përzgjedhja do të bëhet sipas lëndëve prioritare dhe atë sipas programeve në vijim:

I. Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit, BSc

1. Ekonomi/ Ndërmarrësi;
2. Gjeografi/ Histori;
3. Informatikë/TIK.

II. Inxhinieri Industriale me Informatikë, BSc

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

III. Informatika e Aplikuar, BSc

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

IV. Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve, BSc

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

V. Dizajn Grafik dhe Multimedia, Bachelor Profesional

1. Informatikë;
2. Lëndët nga fusha e Arteve;
3. Gjuhë Angleze.

VI. Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, BSc

1. Informatikë/TIK;
2. Matematikë;
3. Ekonomi/ Ndërmarrësi.